

Më
Data 30 - 11 - 20 18

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:015476
Datë: 17.10.2018
Numri i dokumentit: 00147798

P.nr.2834/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i Përgjithshëm-
Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtarit Elmaz Zenuni me zyrtaren ligjore
Liridona Mehmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] fshati [REDACTED]
[REDACTED] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188
par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në
Ferizaj PP/II.nr.895-1/17 të dt.06.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor të
mbajtur më datën 17.10.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit
dhe të dëmtuarit, të njëjtën ditë morri dhe publikishtë shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt,
lindur me dt. [REDACTED] në [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] ka të
kryer shkollën fillore, punon në Mobilerinë [REDACTED] me seli në Ferizaj, i pa martuar, i
gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës
së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt., 01.05.2017 rreth orës 10:30 në fshatin Prelez i të Muahxherëve Komuna e Ferizajt, për shkak të mosmarrëveshjes me të dëmtuarin [REDAKTUAR], ashtuqë deri sa i dëmtuari ishte duke e kullotur bagëtinë, i pandehuri i kishte kërkuar një cigare të dëmtuarit, i njejtë nuk i kishte dhënë cigare i pandehuri në shenjë revolte me dashje që të i shkaktoj lëndime trupore të dëmtuarit e sulmon fizikisht, në atë mënyrë që fillimisht e godet me një shkop druri në kokë, mjet i përrshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore më pas e godet me boksa në pjesë të ndryshme t trupit, me ç, rast të dëmtuarit i shkakton lëndiem të lehta trupore me pasoja të përkohëshme për shëndetin,-

-me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nënpar.1.1, 43 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366 , 450 dhe 463 të KPRK-së, të pandehurin e :

GJYKON

Me dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /me shkronja: treqind euro/, i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 dite pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse denimin me gjobë nuk e paguan i pandehuri sipas këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, gjykata dënimin me gjobë ia zëvendëson me dënim burgu dhe ate duke llogaritur që për 20 € do të vujaj një ditë burgu, dhe ate në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë në kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Gjithashtu, gjykata obligoj të pandehurin që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 30.00 €, dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20.00 €, dhe ate

në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë në kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt për realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Prokurorisë Themelore në Ferizaj me aktakuzën e vetë PP/II.nr.895-1/17 të dt.06.11.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me dt.17.10.2018 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar gjyqësor në të cilin ka marrur pjesë prokurori i shtetit Valdet Avdiu , i cili ka lexuar aktin akuzues, duke mbetur në tërësi pran aktit akuzues, si dhe duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar nuk ka marrur pjesë edhe i dëmtuari [REDAKTUAR] i cili ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt, por në shqyrtim gjyqësor nuk është paraqitur.

Gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 të KPPRK-së pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. I akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt në shqyrtimin fillestar gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shprehur kështu pendimin e thellë për këtë veprë dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej asnjëherë veprë penale me të dëmtuarin janë pajtuar.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajsisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së, janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: deklarata e të dëmturit [REDAKTUAR] dhënë në procedurën hetimore, Ekspertizaa mjeko-ligjor e Ekspertit Dr [REDAKTUAR] e dt.31.10.2017, si dhe shkresav tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer por nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet, me të dëmtuarin [REDAKTUAR] janë pajtuar dhe nuk kanë asgjë të keqe, është i gatshëm të i

kërkon falje për këtë veprë dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së denimit si rrethana lehtësuese ti ketë theksësimet e sipër theksuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figureën e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri ka pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërmarrura kundër [REDAKTUAR] i pa martuar, punun në mobileri me të ardhura të vogla, duke qenë i bindur se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet qëllimi ndëshkimor, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave gjykata aplikoi dispozitën ligjore të nenit 76 par.1 nënpar.1.7 të KPRK-së, dhe bëri zbutjen e dënimit nga burgu në dënim me gjobë, pasi që vepra penale është e parapar me dënimin me burg deri në 3 vjet pa minimum ligjor të përcaktuar gjykata ia ka zbutur dënimin të akuzuarit duke i shqiptuar dënim të butë dhe atë me gjobë, lartësia e të cilit dënim është e përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2018:015476
Datë: 17.10.2018
Numri i dokumentit: 00147798

Bazuar në nenet 458,459 dhe 460 KPPRK-së, i dëmtuari [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt , në emër të kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.


Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPRK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 30 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale-Ekspertizën në lartësi prej 20 eurove i cili është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të të akuzuarit, dhe çështje penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
P.nr.2834/2017 të dt.17.10.2018

Zyrtarja ligjore,
Liridona Mehmeti

Gjyqtari,
Elmaz Zenuni


KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit

Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpër mes të kësaj gjykate.

I dëmtuari mund të ushtroj ankesë vetëm sa i përket Vendimit për sanksionin penal.

Një kopje e aktgjykimit i dërgohet/ [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt.